



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E FINANCAVE

RAPORT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

JANAR – QERSHOR 2025

Shkup, korrik 2025

PËRMBAJTJA

Përmbledhja	2
1. Trendet ekonomike ndërkombëtare	3
2. Trendet makroekonomike në vend.....	4
2.1. Aktiviteti ekonomik.....	4
2.2. Tregu i fuqisë punëtore	5
2.3. Inflacioni dhe zhvillimet monetare	6
2.4. Bilanci i pagesave	7
2.5. Perspektiva makroekonomike për vitin 2025.....	7
3. Sektori fiskal.....	9
3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut	9
3.1.1. Realizimi i buxhetit themelor.....	11
3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve	13
3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive vetanake për të hyrat e shfrytëzuesve buxhetorë.....	14
3.1.4 Realizimi i buxhetit të RMV-së sipas shfrytëzuesve buxhetorë	14
3.2. Menaxhimi i borxhit publik.....	16

Përmbledhja

- Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, aktiviteti ekonomik shënoi rritje reale prej 3.0%, duke vazhduar dinamikën nga gjysma e dytë të vitit 2024. Shtytësi kryesor i rritjes ishte kërkesa vendase, e mbështetur nga rritja e konsiderueshme e investimeve bruto dhe rritja stabile e konsumit personal;
- Sipas të dhënave në Anketën e fuqisë punëtore (AFP), shkalla e papunësisë në tremujorin e parë të vitit 2025 ishte 11.7%, që paraqet ulje prej 0.2 pikë përqindjeje në krahasim me tremujorin paraprak, si dhe 1.2 pikë përqindjeje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024;
- Gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, norma mestare e inflacionit ishte 3.8% në nivel vjetor. Rritja e inflacionit në pjesë më të madhe rezultoi nga komponenti ushqimor, që u përshpejtua gjatë kësaj periudhe, ashtu si edhe inflacioni bazik. Çmimet e produkteve ushqimore dhe energjisë u rritën respektivisht për 3.8% dhe 0.3%, ndërsa derivatet e naftës u ulën për 6.7%. Inflacioni bazik gjatë periudhës janar – qershor 2025 ishte 5.2%;
- Rritja ekonomike në vitin 2025 pritet që të arrijë 3.7%, sipas skenarit makroekonomik në Strategjinë fiskale 2026-2030. Kërkesa vendase pritet që të ketë kontribut të konsiderueshëm pozitiv ndaj rritjes, duke ngadalësuar njëkohësisht kontributin negativ të eksportit neto;
- Gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2025, të hyrat e përgjithshme buxhetore u realizuan në vlerë prej 156.534 milionë denarë, që paraqet 43.6% e vlerës së planifikuar për vitin 2025 dhe në krahasim gjysmën e parë të vitit të kaluar, ato shënuan rritje për 8.5%;
- Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme buxhetore gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2025 ishte 182.249 milionë denarë, që paraqet 45.5% të planit vjetor dhe në krahasim me gjysmën e parë të vitit të kaluar ato u rritën për 8.4%;
- Gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2025, në Buxhetin e RMV-së u realizua deficit prej 25.715 milionë denarëve, që paraqet 2.51% të PBB-së së projektuar për vitin 2025, ndërsa deficitin primar u realizua në vlerë prej 1.3% të PBB-së së projektuar për vitin 2025;
- Borxhi shtetëror i RMV-së në fund të tremujorit të parë të vitit 2025 ishte 50.1% të PBB-së, ndërsa borxhi publik ishte 57.7% të PBB-së.

1. Trendet ekonomike ndërkombëtare¹

Pasiguritë dhe ndryshimet e reja sa i përket politikave, përkatësisht doganat e vendosura nga SHBA-ja rrezikuan sistemin tregtar global dhe shkaktuan pasiguri, me ç'rast testuan rezistencën e ekonomisë globale. Nga muaji shkurt i vitit 2025, u publikuan dhe u implementuan shumë masa të reja tregtare prej SHBA-së dhe kundërmasa nga partnerët e saj tregtarë, që në mënyrë të konsiderueshme çrregulluan perspektivat për rritjen globale. Ndryshimi i politikave mund të shkaktojë tension të madh në kushtet financiare dhe largim të kapitalit, që veçanërisht do të ndikojë mbi vendet në zhvillim. Sipas raportit në fjalë, sigurimi i sistemit tregtar funksional ndërkombëtar në bazë të rregullave dhe ruajtja e tregjeve të hapura mbeten edhe më tej të jenë aspekte thelbësore.


Problem shtesë është edhe hapësira fiskale e vendeve. Përkrahja e siguruar fiskale e mbështeti rimëkëmbjen e ekonomive gjatë pandemisë dhe pas saj, gjithashtu në kushtet e rritjes së konsiderueshme të çmimeve të produkteve ushqimore dhe energjensave, por nga ana tjetër, ka shkaktuar edhe rritjen e borxhit. Deficitet buxhetore vijojnë të jenë edhe më tej të mëdha dhe kufizojnë perspektivat për rritjen ekonomike. Vendet, pavarësisht hapësirës së reduktuar fiskale, përballen edhe me ngadalësimin e rritjes, përkatësisht të dhënat e fundit me frekuencë të lartë tregojnë uljen e aktivitetit ekonomik.

Sipas raportit të FMN-së për muajin prill, rritja ekonomike globale parashihet që të ngadalësohet nga projeksioni prej 3.3% në vitin 2024 në 2.8% në vitin 2025, me ç'rast, për të gjitha vendet pothuajse është bërë rishikim në rënie të rritjes. Rritja shënoi ulje për 0.5 p.p. për vitin 2025 dhe ishte nën mesataren historike prej 3.7% (periudha 2000 – 2019).

Rritja në eurozonë pritet të ketë rënie të lehtë nga 0.9% në vitin 2024 në 0.8% në vitin 2025. Projektionet për rritje në eurozonë në vitin 2025 u rishikuan në linjë rënëse për 0.2 p.p., në krahasim me raportin e muajit janar. Rritja e pasigurisë dhe doganat ishin faktorët kryesorë për rritjen më të ulët në vitin 2025.

Inflacioni global pritet që të vazhdojë me trendin në rënie, por me ritëm më të ngadalësuar, përkatësisht të ulët nga 5.7% në vitin 2024 në 4.3% në vitin 2025. Në ekonomitë e zhvilluara, në krahasim me ekonomitë me rritje të shpejtë dhe vendet në zhvillim, parashihet që inflacioni t'i afrohet më shpejtë projektionit, duke arritur nivelin prej 2.2% në vitin 2026. Krahasuar me raportin për muajin janar, projektioni për inflacionin global është pak më i lartë për vitin 2025. Për ekonomitë e zhvilluara, inflacioni për vitin 2025 u rishikua në rritje për 0.4 p.p., respektivisht 4.4%. Projektioni për eurozonën mbetet i pandryshuar, përkatësisht pritet që të jetë 2.1% në vitin 2025.

Grafiku 1. Rritja reale e PBB-së (%)



Risqet për arritje të perspektivës së rritjes ekonomike globale kryesisht janë në rënie, si në periudhë afatshkurtër ashtu edhe në atë afatmesme. Risku kryesor rezulton nga pasiguria lidhur me doganat e vendosura nga SHBA-ja dhe masat reciproke të ndërmarra nga vendet e tjera. Doganat do të kenë efekt të theksuar negativ

¹ Analiza në këtë pjesë bazohet mbi raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) nga muaji prill i vitit 2025


mbi PBB-në globale, por me diferencë të konsiderueshme ndërmjet vendeve. Vendet që tangohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me tarifën, kryesisht Kina dhe SHBA-ja, do të tangoheshin më shumë, si dhe një numër i madh i vendeve të Azisë dhe Evropës. Efekti i përgjithshëm nga vendosja e tarifave do të varet nga fakti se sa shpejtë vendet mund ta rrisin kërkesën vendase, të gjejnë partnerë të rinj tregtarë ose ta rrisin konkurrencën. Gjithashtu është mundur edhe krijimi i klasterëve të rinj tregtarë, që do të ndikonte edhe mbi zhvillimin e investimeve të huaja direkte. Lufta tregtare mund t'i rrisë presionet me çmimet dhe njëkohësisht të ndikojë edhe mbi rritjen e inflacionit, më së shumti duke rritur çmimet e importit. Përveç pengesave tregtare, pasiguria e prolonguar lidhur me tarifën do të ndikojë negativisht edhe mbi investimet, si pasojë e vonës së projekteve investuese nga ana e kompanive.

2. Trendet makroekonomike në vend²

2.1. Aktiviteti ekonomik

Në tremujorin e parë të vitit 2025, produkti i brendshëm bruto (PBB) shënoi rritje vjetore prej 3.0% në bazë reale, me ç'rast u ruajt trendi pozitiv nga gjysma e dytë e vitit të kaluar. Rritja, kryesisht ishte nxitur nga rritja e kërkesës vendase, mbi të gjitha nga rritja e konsiderueshme e investimeve bruto nga 18%, si dhe nga konsumi stabil. Ndërtimtaria dhe kreditimi i sektorit korporativ kontribuan për rritjen dyshifrore të investimeve bruto, ndërsa rritja e të ardhurave në dispozicion të amvisërve kontriboi në rritjen e konsumit personal prej 2.1%. Eksporti neto pati kontribut negativ në rritje gjatë tremujorit të parë të vitit, me dinamikë më të theksuar të rritjes së importit, ndërsa eksporti i mallrave dhe shërbimeve u rikuperua në mënyrë të moderuar dhe hyri në zonën pozitive për herë të parë pas shtatë tremujore pasuese, me rritje prej 1.2%.

Grafiku 2. Struktura e shpenzimeve të rritjes ekonomike (kontributi në rritje, pikë përqindje)



Duke analizuar sipas veprimtarive, rritja e aktivitetit ekonomik gjatë tremujorit të parë ishte për shkak të realizimeve pozitive në sektorin e shërbimeve, që shënoi rritje prej 2.2%, ndërtimtaria me rritje të realizuar të konsiderueshme prej 7.1% dhe sektori industrial me rritje prej 2.1%. Sektori i minierave dhe gurorëve, si dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar shënuan rrënie prej 3.5%, përkatësisht 1.1%. bujqësia shënoi rritje të moderuar prej 0.7%, duke e vazhduar trendin pozitiv nga dy tremujorët e mëparshëm.

² Në raport shfrytëzohen të dhënat më të fundit në dispozicion. Për PBB-në, papunësinë dhe bilancin e pagesave, të dhënat janë të disponueshme deri në tremujorin e parë të vitit 2025.

Grafiku 3. Struktura e rritjes ekonomike sipas metodës prodhuese (kontributi në rritje, p.p.)



Sipas të dhënave me frekuencë të lartë, prodhimi industrial në muajin maj të vitit 2025 shënoi rritje të lartë prej 9.4%, në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa në bazë kumulative, gjatë periudhës janar – maj të vitit 2025, industria u rrit për 3.3%. Rritja në muajin maj të vitit 2025 ishte për shkak të rritjes së prodhimit në sektorin e minierave dhe gurorëve për 18.8% dhe sektorin e industrisë së përpunimit për 9.0%, ndërsa sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar shënoi rënie prej 11.8%.

Tregtia e jashtme tregoi shenja rikuperimi, falë rritjes së madhe të eksportit në muajin maj, që arriti në 23.4% krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, që rezultoi me rritje kumulative prej 3.2% për periudhën janar – maj. Rritja e eksportit në muajin maj kryesisht ishte si rezultat i rritjes së eksportit të automjeteve rugore (194.1%), duhanit dhe produkteve të duhanit (140.4%), si dhe makinave elektrike, aparateve dhe pjesëve (25.7%). Nga ana tjetër, importi shënoi rritje prej 1% gjatë pesë muajve të parë, që kontribuoi në uljen e deficitit tregtar për 4%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit, në muajin maj të vitit 2025 shënoi rritje në mënyrë të konsiderueshme prej 80.4%, ndërsa vlera e përgjithshme e punëve të parashikuara ndërtimore u rrit për 34.1%. Gjatë periudhës janar – maj të vitit 2025, numri i lejeve të ndërtimit u rrit për 18.1%, ndërsa vlera e përgjithshme të punëve të parapara ndërtimore shënoi rritje vjetore prej 46.4%, që tregon ritjen e aktivitetit investues në sektorin e ndërtimit.

Sa i përket tregtisë së brendshme, në muajin maj të vitit 2025 u evidentua rritje nominale prej 3.0% në nivel vjetor, me ç'rast rezultate pozitive u regjistruan në tregtinë me pakicë dhe me shumicë, si dhe në tregtinë me automjete motorike dhe riparime. Në mënyrë kumulative, rritja gjatë periudhës janar – maj ishte 1.3%.

2.2. Tregu i fuqisë punëtore


Sipas të dhënave nga Anketa e fuqisë punëtore (AFP), shkalla e papunësisë ishte 11.7%, që paraqet ulje prej 0.2% pikë përqindjeje (p.p.), në krahasim me tremujorin e kaluar, përkatësisht 1.2 p.p., në raport me tremujorin e njëjtë të vitit 2024.

Njëkohësisht, shkalla e punësisë arriti në 46.3%, duke shënuar rritje të vogël prej 0.1 p.p., në krahasim me tremujorin e kaluar dhe rritje të konsiderueshme prej 0.9 p.p. në raport me tremujorin e parë të vitit 2024. Gjegjësish, numri i të punësuarve shënoi rritje për 1.884 persona (0.3%) në krahasim me tremujorin e kaluar, ndërsa në nivel vjetor, ky numër shënoi rritje për 15.059 persona (2.2%). Shkalla e aktivitetit ishte 52.4%, që paraqet rritje prej 0.3 p.p., në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2024, ndërsa në raport me tremujorin e kaluar është vërejtur ulje prej 0.1 p.p..

Gjatë katër muajve të parë të vitit 2025, paga mesatare neto shënoi rritje prej 9.9% në bazë nominale (Grafiku 4). Rritja e pagave u regjistrua në të gjitha veprimtaritë, me rritje më të theksuar në arsim, veprimtaritë

lidhur me pronën e tundshme, artin, argëtimin dhe rekreacionin, si dhe në veprimtaritë administrative, shërbyese dhe ndihmëse.


Grafiku 4. Rritja e pagës mesatare neto (në %)



2.3. Inflacioni dhe zhvillimet monetare

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, norma mesatare e inflacionit shënon 3.8% në nivel vjetor me trend të dukshëm në rritje gjatë dy muajve të parë, për shkak të presionit të konsiderueshëm të komponentit ushqimor. Nga fundi i muajit shkurt kanë hyrë në fuqi masat³ e Qeverisë për kufizimin e marzhit të disa grupeve të produkteve ushqimore bazë, që rezulton me ngadalësim të theksuar të çmimeve në muajin mars dhe prill. Inflacioni u përshpejtua sërish në muajin maj dhe qershor, që vjen pas përfundimit të masave të Qeverisë, që ishin në fuqi deri në fund të muajit prill. Në mënyrë kumulative, gjatë gjashtë muajve të parë, çmimet e produkteve ushqimore u rritën për 3.8%, të energjisë për 0.3%, ndërsa të derivateve të naftës janë ulur për 6.7%. Inflacioni bazë gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2025 u përshpejtua dhe shënon 5.2%.

Grafiku 5. Inflacioni i përgjithshëm dhe bazik (në %)



Në përputhje me nevojën e stabilizimit të inflacionit dhe pritshmëritë e inflacionit në bazë më të qëndrueshme, Banka Popullore edhe gjatë muajit qershor të vitit 2025, e ruajti normën bazë të interesit në nivel prej 5.35%, që ka ngelur e pandryshuar nga muaji shkurt i vitit 2025.

³ Më datë 20.02.2025, në fuqi hyri vendimi për kufizimin e marzhit të 102 grupeve të produkteve ushqimore bazë dhe mjeteve higjienike, si dhe për kufizimin e çmimeve të 8 grupeve të produkteve ushqimore bazë. Masat ishin në fuqi deri në datën 30.04.2025. Me vendimin për kufizimin e marzhit të fitimit bruto në tregtinë me shumicë dhe pakicë u përfshin 102 grupe produktesh, përkatësisht:

- marzhi i fitimit bruto për 5% për 8 produkte ushqimore bazë;
- marzhi i fitimit bruto për 10% për produkte ushqimore, respektivisht grupi prej 55 produkte ushqimore (mishi dhe përpunimet prej mishit, sheqeri, produktet e qumështit, margarina, gjalpi, perimet dhe frutat e konservuara, fasulet, orizi dhe brumërat).


Në muajin maj të vitit 2025, aktiviteti kreditor u rrit për 12.1% në nivel vjetor në kushtet e rritjes së kreditimit të ndërmarrjeve për 14.3% dhe amvisërive për 10.1%, ndërsa potenciali i përgjithshëm i depozitave ka realizuar rritje vjetore prej 12.2%.

2.4. Bilanci i pagesave

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave ka evidentuar deficit prej 339 milionë eurove, që është për 72.4% më i lartë në krahasim me deficitin në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo, kryesisht është si rezultat i rënies së suficitit të shërbimeve dhe remitancat, ndërsa kontribut më të vogël negativ pati edhe rritja e deficitit të mallrave dhe të ardhurave primare.

Investimet e huaja direkte (IHD) gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 ishin 135.8 milionë euro dhe në nivel vjetor shënuan ulje për 58.5%, që kryesisht ishte për shkak të fluksit dalës në bazë të instrumenteve të borxhit.

Grafiku 6. Saldoja e llogarisë rrjedhëse dhe fluksi hyrës i IHD-ve (në miliona euro)



Rezervat devizore në muajin qershor të vitit 2025 ishin në vlerë prej 4.7 miliardë eurove, që paraqet rritje prej 8.3% në nivel vjetor, duke siguruar mbulimin e importit të mallrave dhe shërbimeve prej 4.8 muajve nga periudha e mëparshme 12-mujore, që paraqet nivel përkatës rezervash.

2.5. Perspektiva makroekonomike për vitin 2025

Sipas skenarit bazë makroekonomik, pas rimëkëmbjes së ekonomisë në vitin 2024, në vitin 2025 pritet përsheptimi i aktivitetit ekonomik me rritjen e projektuar prej 3.7%. Në kushte të rrethanave të pasigurisë së jashtme, shtytësi kryesor i rritjes pritet që të jetë konsumi vendas.

Investimet bruto pritet që ta kenë rolin kryesor në zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Rritja e fuqishme gjatë tremujorit të parë të këtij viti pritet që të vijojë edhe gjatë vitit 2025 me projektim në nivel prej 8.6%, si rezultat i intensifikimit të realizimit të projekteve të mëdha infrastrukturore të financuara nga shteti (korridoret 8 dhe 10 dhe infrastruktura hekurudhore) dhe investimeve kapitale të komunave për të cilat janë siguruar mjete financiare shtesë me kushte të favorshme. Impuls të konsiderueshëm pritet edhe nga realizimi i investimeve private në kapacitete prodhuese dhe eksportuese me sigurimin e mjeteve me kushte jashtëzakonisht të favorshme, duke pasur parasysh se vetëm gjatë pesë muajve të parë të këtij viti është tërhequr gjysma e vlerës së paraparë.

Në vitin 2025, konsumi privat pritet të shënojë rritje reale prej 2.6%, në kushtet e rritjes reale të pagave dhe punësimit, rritjes së kreditimit dhe ruajtjes së një niveli solid të transfertave private dhe rritjes së pensioneve nga muaji mars i vitit 2025, ku u rrumbullakua rritja e parashikuar prej 5.000 denarësh.

Konsumi publik në vitin 2025 pritet të ngadalësohet dhe është parashikuar të jetë 2.9%, i mbështetur nga rritja e pagave në disa sektorë të administratës publike (para së gjithash në arsim dhe shëndetësi), si dhe nga harmonizimi i pagës minimale.

Aktiviteti eksportues, i cili në dy vitet e fundit shënoi ulje, në vitin 2025 pritet të rimëkëmbet dhe të shënojë rritje prej 2.2%. Në kushtet e rritjes së moderuar të aktivitetit eksportues dhe rritjes së kërkesës vendore, rritja reale e importit të mallrave dhe shërbimeve është projektuar të jetë 3.3% në vitin 2025, gjë që implikon kontribut negativ të eksportit neto kundrejt rritjes ekonomike.

Zhvillimet pozitive të tregut të punës që nga fillimi i këtij viti pritet të vazhdojnë edhe gjatë gjithë vitit 2025. Rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2025 do të ketë ndikim pozitiv në punësim, me ç'rast është parashikuar rritje e numrit të të punësuarve prej 1.6%. Përkrahje e theksuar për punësime pritet nga Plani operativ i punësimeve për vitin 2025, i cili parasheh mjete të konsiderueshme për programet dhe masat aktive për punësim me fokus të veçantë të të rinjtë, gratë dhe kategoritë e shtresave në nevojë të popullsisë, për përfitimin e shkathtësive, kualifikimet shtesë dhe riaftësimin, si dhe përkrahjen e sipërmarrjes. Shkalla e papunësisë pritet të ulet në nivel prej 11.1% në vitin 2025, ndërsa shkalla e punësimit të arrijë në 47%.

Në vitin 2025, pritet edhe më tej stabilizimi i inflacionit, përkatësisht, ai është projektuar të jetë në nivel prej 2.8%. Inflacioni bazik, i cili shënoi ngadalësim në muajt e fundit, pritet ta ruajë trendin edhe në periudhën e ardhshme. Projektionet e inflacionit bazohen në pritshmërinë e zbatimit konsekuent të Ligjit të Praktikave të Padrejta Tregtare, i cili duhet ta parandalojë rritjen e pajustifikuar të çmimeve, përkatësisht të produkteve ushqimore bazë.

Në vitin 2025, saldoja e llogarisë rrjedhëse e bilancit të pagesave pritet të shënojë deficit më të moderuar prej 2.2% të PBB-së krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i kontributit më të vogël negativ të eksportit neto. Zhvillimet pozitive në flukset hyrëse të IHD-ve pritet të vazhdojnë në vitin 2025, megjithëse me një ritëm më të moderuar krahasuar me vitin 2024, gjë që do të ketë ndikim të favorshëm në ruajtjen e rezervave devizore në nivel të përshtatshëm.

Skenari makroekonomik bazë shoqërohet me risqe, të cilat vlerësohen në rënie krahasuar me rritjen ekonomike të projektuar. Konfliktet në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme, të cilat vazhdojnë edhe përkundër përpjekjeve për ndaljen e aktiviteteve luftarake dhe sidomos pasiguria rreth politikave doganore, mund të shkaktojnë efekte të padëshirueshme kundrejt zinxhirëve të furnizimit dhe shkëmbimeve tregtare globale. Përkeqësimi i besimit në nivel ndërkombëtar mund t'i ngadalësojë vendimet e kompanive për t'i realizuar investimet kapitale. Në lidhje me faktorët e brendshëm, realizimi i ngadalë i investimeve kapitale dhe reformave të parapara mund ta vonojnë dianamizimin e pritur të aktivitetit ekonomik. Risqet e projektionit të inflacionit lidhen me lëvizjen e çmimeve të produkteve primare, përkatësisht rritjen e tyre për shkak të faktorëve gjeopolitikë dhe ndërprerjes së zinxhirëve të furnizimit.

Tabela 1. Krahasimi i projeksioneve të rritjes ekonomike dhe inflacionit për vitin 2025 (në %)

	Rritja ekonomike	Inflacioni
Ministria e Financave	3.7	2.8
FMN-ja	3.2	3.4
Banka Botërore	2.6	2.5
Komisioni Evropian	3.0	2.7
BERZH-i	2.6	/
Agjencia Kreditore "Fitch"	3.6	3.0
Banka Popullore e RMV-së	3.0	3.0


Burimi: Projektionet e Ministrisë së Financave (Strategjia fiskale 2026 - 2030, maj 2025), FMN-së (IMF World Economic Outlook, prill 2025), Bankës Botërore (Western Balkans Regular Economic Report, prill 2025), Komisionit Evropian (European Economic Forecast, maj 2025), BERZH-it (Regional Economic Prospects, maj 2025), Agjencisë Kreditore "Fitch" (Fitch Ratings, prill 2025) dhe Bankës Popullore të RMV-së (Raporti tremujor, maj 2025).

3. Sektori fiskal

3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 2025, të hyrat e përgjithshme janë planifikuar të jenë në vlerë prej 358.838 milionë denarëve, shpenzimet e përgjithshme në vlerë prej 400.188 milionë denarëve, përkatësisht deficitin është planifikuar në vlerë prej 41.350 milionë denarëve (deficitin e buxhetit themelor 34.668 milionë denarë, deficitin e fondeve 2.586 milionë denarë dhe deficitin e llogarive për të hyrat vetanake 4.096 milionë denarë).

Grafiku 7. Skena skematike e Buxhetit të RMV-së, realizimi (në miliona denarë) dhe shkalla e realizimit (në %) në gjysmën e parë të vitit 2025



Realizimi i të hyrave të përgjithshme buxhetore në periudhën janar - qershor 2025 ishte 156.534 milionë denarë, që paraqet 43.6% e vlerës së planifikuar për vitin 2025, përkatësisht rritje prej 8.5% krahasuar me të hyrat e realizuara buxhetore në të njëjtën periudhë të vitit 2024 (Tabela 2). Në kuadër të të hyrave të përgjithshme, 142.370 milionë denarë janë realizuar në bazë të të hyrave tatimore dhe kontributve sociale, me ç'rast norma e realizimit është 44.6% nga vlera e planifikuar për vitin 2025, përkatësisht rritje prej 6.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjithashtu, të hyrat tatimore u realizuan në vlerë të përgjithshme prej 87.715 milionë denarëve⁴ (realizim prej 43.4% të vlerës së planifikuar për vitin 2025), ndërkohë që kompensimet u realizuan në vlerë prej 54.655 milionë denarëve (ritje vjetore prej 8.9%, përkatësisht 46.7% nga vlera e planifikuar për vitin 2024). Në kuadër të të hyrave tatimore kishte rritje të të gjitha të hyrave, përveç të hyrave të tjera tatimore vijuese: detyrimet tatimore për 16.1%, akcizat për 8.1%, tatimi mbi të ardhurat personale për 6.6%, tatimi mbi vlerën e shtuar 2.8%, tatimi mbi fitimin 0.9%, ndërsa të hyrat e tjera tatimore shënohet rënie për 16.2%.

Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme të Buxhetit të RMV-së në periudhën janar - qershor 2025 ishte 182.249 milionë denarë, që paraqet 45.5% të planit vjetor, përkatësisht rritje prej 8.4%, krahasuar me gjysmëvjetorin e vitit 2024. Gjithashtu, shpenzimet rrjedhëse u realizuan në vlerë prej 169.629 milionë denarë ose 48% nga vlera e planifikuar për të gjithë vitin, që paraqet rritje prej 9.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Rritje kishte edhe të shpenzimet e interesit, respektivisht 9.3% të shpenzimet për mallrat dhe shërbimet për 0.8% dhe të pagat dhe kompensimet për 10.4%. Transferrat, që janë kategoria më e madhe e shpenzimeve rrjedhëse, u rritën për 9.9%, të nxitura nga rritja e lartë e transfertave sociale prej 12.1%, shpenzimet për mbrojtjen shëndetësore prej 8.3%, dotacionet blok dhe ato të destinuara prej 9.8%. Shpenzimet kapitale u realizuan në vlerë prej 12.620 milionë denarë, respektivisht ishin më të ulëta për 2.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Shkalla e realizimit të shpenzimeve kapitale në gjysmëvjetorin e parë në lidhje me buxhetin fillestar ishte 26.8%.

⁴ Gjithashtu përfshihen edhe të hyrat nga llogaritë vetanake në vlerë prej 743 milionë denarëve.

Tabela 2. Realizimi i Buxhetit të RMV-së për periudhën janar – qershor 2025

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

	Buxheti 2025	janar - qershor 2025		
	miliona denarë	miliona denarë	shkalla vjetore e rritjes (në %)	shkalla e realizimit
TË HYRA TË PËRGJITHSHME	358.838	156.534	8.5%	43.6%
Tatime dhe kontribute	319.234	142.370	6.3%	44.6%
Tatime	202.139	87.715	4.7%	43.4%
Tatimi mbi të ardhurat personale	35.676	15.700	6.6%	44.0%
Tatimi mbi fitimin	23.287	12.065	0.9%	51.8%
TVSH	86.692	37.165	2.8%	42.9%
Akcizat	35.388	14.540	8.1%	41.1%
Detyrime të importit	16.255	7.063	16.1%	43.5%
Të hyra të tjera tatimore	4.841	1.182	-14.7%	24.4%
Kontribute	117.095	54.655	8.9%	46.7%
Të hyra jotatimore	26.302	11.189	27.3%	42.5%
Të hyra kapitale	3.510	477	36.8%	13.6%
Donacione nga jashtë	9.792	2.498	108.9%	25.5%
Të hyra nga huatë e arkëtuara	0	0	/	/
SHPENZIME TË PËRGJITHSHME	400.188	182.249	8.4%	45.5%
Shpenzime rrjedhëse	353.032	169.629	9.3%	48.0%
Paga dhe kompensime	48.141	23.253	10.4%	48.3%
Mallra dhe shërbime	26.325	10.477	0.8%	39.8%
Transferta	257.721	123.629	9.9%	48.0%
Transferta sociale	191.046	92.441	12.1%	48.4%
SPIM	119.995	60.196	15.9%	50.2%
Kompensimi financiar për të papunësuarit	3.439	746	-10.9%	21.7%
Ndihma sociale	15.080	7.484	-0.4%	49.6%
Mbrojtja shëndetësore	52.531	24.015	8.3%	45.7%
Transferta të tjera	66.675	31.188	3.9%	46.8%
Interesi	20.845	12.270	9.3%	58.9%
Shpenzime kapitale	47.156	12.620	-2.4%	26.8%
SALDOJA E BUXHETIT	-41.350	-25.715	8.0%	62.2%

Burimi: Ministria e Financave

Në periudhën janar - qershor të vitit 2025 në Buxhetin e RMV-së u realizua deficit prej 25.715 milionë denarëve, që paraqet 2.51% të PBB-së së projektuar për vitin 2025, përkatësisht 62.2% të planit vjetor (Tabela 2).

Në kuadër të Buxhetit të RMV-së, buxheti themelor realizoi deficit prej 29.303 milionë denarëve, fondet e suficitit prej 4.054 milionë denarëve, ndërsa llogaritë e të hyrave vetanake realizuan deficit në vlerë prej 466 milionë denarëve.


3.1.1. Realizimi i buxhetit themelor

Të hyrat e përgjithshme të buxhetit themelor në periudhën janar - qershor të vitit 2025 ishin 94.394 milionë denarë. Ato paraqesin 44.6 të të hyrave të përgjithshme të parapara për vitin 2025, në vlerë prej 211.647 denarëve.

Arkëtimi i të hyrave tatimore në këtë periudhë, të cilat paraqesin zërin më të rëndësishëm në kuadër të të hyrave të përgjithshme, ishin 86.242 milionë denarë, përkatësisht 43.8% të planit vjetor, ndërsa të hyrat jotatimore dhe kapitale u realizuan në vlerë prej 6.953 milionë denarëve ose 51.4% krahasuar me vlerën e planifikuar për të gjithë vitin.

Struktura e të hyrave tatimore të realizuara tregon se tatimi mbi vlerën e shtuar ka pjesëmarrjen më të madhe me 37.165 milionë denarë ose 43.1% e të hyrave tatimore të përgjithshme (Grafiku 8). Pastaj vijojnë të hyrat mbi bazën e tatimit të të ardhurave personale me 15.700 milionë denarë, akcizat me 13.810 milionë denarë, tatimi mbi fitimin me 12.065 milionë denarë, detyrimet importuese me 7.063 milionë denarë dhe të hyrat e tjera tatimore me 439 milionë denarë.


Grafiku 8. Struktura e të hyrave tatimore, janar – qershor 2025



Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit themelor në periudhën janar – qershor të vitit 2025 shënon 123.697 milionë denarë ose 50.2% e mjeteve të përgjithshme të parapara me buxhetin themelor për vitin 2025.


Në strukturën e shpenzimeve të kryera në këtë periudhë, pjesëmarrjen më të madhe e zënë transfertat rrjedhëse në fondet buxhetore me 30.380 milionë denarë. Pastaj vijojnë pagat dhe kompensimet me 21.852 milionë denarë, subvencionet dhe transfertat me 17.487 milionë denarë, transfertat rrjedhëse te njësitë e vetëqeverisjes lokale me 16.137 milionë denarë, pagesat e interesit 12.270 milionë denarë, shpenzimet kapitale me 10.782 milionë denarë, shpenzimet për mallrat dhe shërbimet me 7.410 dhe benefitet sociale me 7.360 milionë denarë. Grafiku 9 tregon përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në shpenzimet e përgjithshme.

Grafiku 9. Struktura e shpenzimeve të realizuara sipas klasifikimit ekonomik, janar – qershor 2025



Shkalla e realizimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve shënon 44.8%. Në Grafikon 10 janë paraqitur të dhëna të dezagreguara për shpenzimet e kryera të mallrave dhe shërbimeve.

Grafiku 10. Shpenzimet për mallrat dhe shërbimet, janar - qershor 2025 (në miliona denarë)



Në gjysmën e parë të vitit, transfertat rrjedhëse të fondet buxhetore paraqesin 27.5% të planit vjetor. Në kuadër të kësaj kategorie, 89.3% janë transferatat që bien në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut (Fondi i FSPIMV-së), ndërsa pjesa tjetër janë transfertat në Fondin e Sigurimit Shëndetësor.


Nga mjetet e përgjithshme të planifikuara për transfertat rrjedhëse të NJVL-të për vitin 2025, në gjysmën e parë të vitit u realizuan 48.5%. Në kuadër të kësaj kategorie, vlera më e madhe ose 42.1% u realizua mbi bazën e dotacioneve bllok dhe atyre të destinuara, ndërsa pjesa tjetër ishte mbi bazën e dotacioneve të TVSH-së.

Shkalla e realizimit në kategorinë e subvencioneve dhe transfertave në periudhën e shqyrtuar ishte 45.7%. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve ose 5.204 milionë denarë janë paguar mbi bazën e subvencioneve bujqësore nga Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Benefitet sociale në periudhën janar - qershor paraqesin 50.7% të planit vjetor

Në periudhën e shqyrtuar, shpenzimet kapitale paraqesin 36.8% të mjeteve të planifikuara për këtë qëllim me buxhetin themelor për vitin 2025, Në Grafikon 11 janë paraqitur të dhëna të dezagreguara për shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve.

Grafiku 11. Shpenzimet kapitale, janar – qershor të vitit 2025 (në miliona denarë)



Në periudhën e shqyrtuar, nga buxheti themelor është kryer pagesa principalit në raport me borxhin e përgjithshëm në vlerë prej 52.424 milionë denarëve, ndërsa pagesat mbi bazën e interesit ishin 12.270 milionë denarë. Nga fluksi dalës i përgjithshëm mbi bazën shlyerjes së kredive, 10.963 milionë denarë ishin dalje për pagesën principalit ndaj kreditorëve vendas, ndërsa 41.461 milionë denarë ishin dalje për pagesën e principalit ndaj kreditorëve jorezidentë. Për shpenzimet mbi bazën e interesit ndaj kreditorëve vendas u paguan 4.640 milionë denarë, ndërsa ndaj kreditorëve të huaj u paguan 7.630 milionë denarë.

3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve

Në gjysmën e parë të vitit, Fondi i FSPIMV-së ka realizuar suficit prej 3.461 milionë denarëve. Duke përfshirë muajin qershor, realizimi i të hyrave dhe fluksit hyrës ishte 68.236 milionë denarë, që paraqet 51.7% krahasuar me planifikimin për vitin 2025, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 64.775 milionë denarë, përkatësisht 48.2% të planit vjetor. Nga të hyrat e përgjithshme, 35.705 milionë denarë ishin të hyra mbi bazën e kontributeve për sigurimin e fondit pensional dhe invalidor (45.4% të planit vjetor), 30.380 milionë denarë ishin transfertat nga buxheti themelor, 730 milionë denarë të hyra nga akcizat, 753 milionë denarë janë të hyra nga vetëpunësimi, 364 milionë denarë ishin të hyra nga të ardhurat personale, 120 milionë denarë ishin të hyra nga bujqit individualë, ndërsa pjesa tjetër prej 184 milionë denarëve ishin të hyra të tjera të Fondit në fjalë.

Në pjesën e shpenzimeve të Fondit të FSPIMV-së, shpenzimet për pensionet u realizuan në vlerë prej 52.026 milionë eurove ose 49.3% nga ato të parapara për vitin 2025. Pagesa e pensioneve u realizua në përputhje me dinamikën e paraparë për vitin 2025. Transfertat nga Fondi i FSPIMV-së te fondet pensionale private ishin 8.170 milionë denarë, ndërsa transfertat e kontributeve për sigurimin shëndetësor të pensionistëve në Fondin e Sigurimit Shëndetësor ishin 4.268 milionë denarë. Shpenzimet për pagat, mallrat dhe shërbimet, si dhe shpenzimet e tjera ishin në vlerë prej 255 milionë denarëve.

Duke përfshirë muajin qershor të vitit 2025, Fondi i Sigurimit Shëndetësor realizoi suficit në vlerë prej 639 milionë denarëve, në rrethana të të hyrave të realizuara në vlerë prej 23.764 milionë denarëve, që paraqet 44.5% të planit vjetor dhe shpenzimeve të realizuara në vlerë prej 24.403 milionë denarëve, përkatësisht 45.7% nga planifikimi për vitin 2025.

Në periudhën e shqyrtuar u realizuan të hyra nga kontributet e sigurimit shëndetësor në vlerë prej 15.451 milionë denarëve ose 48.9% e planit vjetor. Kontributet për sigurimin shëndetësor të pensionistëve të paguara nga Fondi i FSPIMV-së ishin 4.268 milionë denarë, ndërsa kontributet për sigurimin shëndetësor të paguara nga Agjencia e Punësimit të RMV-së ishin 59 milionë denarë. Transfertat nga buxheti themelor ishin 3.610 milionë denarë, të hyrat nga participimi 284 milionë denarë, ndërsa të hyrat e tjera 92 milionë denarë. Në pjesën e shpenzimeve, u realizuan shpenzime për mbrojtjen shëndetësore primare në vlerë prej 20.361 milionë denarëve, shpenzime për raportet mjekësore ishin 3.036 milionë denarë, për ndihmën ortopedike 410 milionë denarë dhe për trajtime shëndetësore jashtë shtetit 208 milionë denarë. Shpenzimet për pagat, mallrat dhe shërbimet, si dhe shpenzimet kapitale ishin 388 milionë denarë.

Në periudhën janar - qershor të vitit 2025, Agjencia e Punësimit të RMV-së ka realizuar suficit në vlerë prej 1.232 milionë denarëve, në rrethana të të hyrave të realizuara në vlerë prej 2.271 milionë denarëve (51% nga planifikimi për vitin 2025) dhe shpenzimeve të realizuara në vlerë prej 1.039 milionë denarëve (23.3% krahasuar me buxhetin vjetor). Kontributet mbi bazën e sigurimeve në rast papunësie janë zëri kryesor i të hyrave dhe ato u realizuan në vlerë prej 2.262 milionë denarëve, përkatësisht 51.3% nga plani vjetor.

Shpenzimet e Agjencisë së Punësimit në gjysmën e parë të vitit: në bazë të kompensimit financiar për personat e papunësuar - 601 milionë denarë, në bazë të mjeteve për punësimin e personave inaktivë - 68 milionë denarë, për masat aktive të punësimit - 145 milionë denarë dhe për pagesën e kompensimeve për sigurimin individual dhe shëndetësor për personat e papunësuar - 59 milionë denarë. Shpenzimet e Agjencisë së Pagave, Mallrave dhe Shërbimeve ishin në vlerë prej 166 milionë denarëve

3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive vetanake për të hyrat e shfrytëzuesve buxhetorë

Në përputhje me buxhetin e RMV-së për vitin 2025 është planifikuar deficitin në buxhetet e llogarive vetanake për të hyrat e shfrytëzuesve buxhetorë (të destinuara për aktivitetet e vetëfinancuara, huatë dhe donacionet) në vlerë prej 4.096 milionë denarëve, ndërsa deficitin i realizuar në periudhën e analizuar ishte në vlerë prej 466 milionë denarëve.

Duke përfshirë muajin qershor të vitit 2025, të hyrat e përgjithshme të realizuara në këto llogari arritën në 6.186 milionë denarë (22.9% e planit për vitin 2025), ndërsa shpenzimet e realizuara arritën në 6.652 milionë denarë (21.4% e buxhetit vjetor). Në kuadër të shpenzimeve, 4.827 milionë denarë ose 36% e planit vjetor u shpenzuan për shpenzime rrjedhëse, ndërsa 1.825 milionë denarë ose 10.3% e planit vjetor u shpenzuan për shpenzimet kapitale.

3.1.4 Realizimi i buxhetit të RMV-së sipas shfrytëzuesve buxhetorë⁵


Në vijim jepet një pasqyrë mbi shpenzimet dhe fluksin dalës nga Buxheti i RMV-së për shfrytëzuesit më të mëdhenj të buxhetit, buxheti i përgjithshëm vjetor i të cilëve paraqet 89.6% të buxhetit të përgjithshëm të të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë (Grafiku 12).

Në gjysmën e parë të vitit 2025, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë ka realizuar 40.586 milionë denarë ose 58.9% nga buxheti i planifikuar për vitin 2025. Pjesa më e madhe (74.5%) e shpenzimeve në këtë periudhë u destinua për transfertat rrjedhëse te fondet, për të cilat janë shpenzuar 30.253 milionë denarë ose 63% e mjeteve të destinuara për vitin 2025. Zëri i dytë i shpenzimeve më të mëdha ishin benefitet sociale, me pjesëmarrje prej 18.1% në shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë qëllim u realizuan 51.8% (7.358 milionë denarë) nga të planifikimi për vitin 2025.

⁵ Të dhënat e detajuara mbi të hyrat dhe shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë janë pasqyruar në tabelat në linkun e mëposhtëm: <https://finance.gov.mk/sq-AL/oblasti/izvestai-trezor>. Të dhënat janë preliminare dhe të pakonsoliduara dhe përfshijnë fluksin hyrës dhe fluksin dalës së mjeteve.

Në periudhën janar – qershor të vitit 2025, përmes ndarjes Ministria e Financave – funksionet e shtetit⁶ u realizuan 76.469 milionë denarë, përkatësisht 65.7% nga mjetet e parapara për vitin 2025. Pagesa e principalit (62.612 milionë denarë) është zëri më i rëndësishëm i shpenzimeve të përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor me pjesëmarrje prej 81.9%, nga mjetet e parapara për vitin 2025, ku u realizuan 75.9%. Realizimi i interesit ishte 50.9% e vlerës së gjithë vitit, përkatësisht 10.611 milionë denarë, ndërsa në shpenzimet e përgjithshme ky zë buxhetor kishte pjesëmarrje me 13.9%. Zëri i tretë më i rëndësishëm, me pjesëmarrje prej 2.8%, ishin transfertat rrjedhëse në njësitë e vetëqeverisjes lokale, për të cilat u shpenzuan 2.157 milionë denarë.

Grafiku 12. Struktura e shpenzimeve dhe fluksit dalës sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar - qershor të vitit 2025



Në periudhën janar - qershor të vitit 2025, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka realizuar mjete buxhetore në vlerë prej 20.487 milionë denarë (46.7% nga planifikimi), të cilat ishin për 6.6% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Pjesën më të madhe të shpenzimeve (57.6%) e zënë transfertat rrjedhëse në NJVL, për të cilat u shpenzuan 11.805 milionë denarë ose 49.3% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara. Pagat dhe kompensimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 22.8% dhe për to u shpenzuan 4.671 milionë denarë, përkatësisht 50% e vlerës së paraparë të përgjithshme.

Në gjysmën e parë të vitit 2025, Ministria e Punëve të Brendshme ka realizuar gjithsej mjete në vlerë prej 7.667 milionë denarëve, që paraqet 47.9% të Buxhetit për vitin 2025, respektivisht 9.6% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Zëri më i rëndësishëm i shpenzimeve janë pagat dhe kompensimet me pjesëmarrje prej 67.2%, ku për to u shpenzuan 5.156 milionë denarë ose 52.2% të planifikimit. Mallrat dhe shërbimet paraqesin zërin e dytë më të rëndësishëm me pjesëmarrje prej 14.2% dhe për këtë zë u realizuan 1.088 milionë denarë, që paraqet 35.8% të planit vjetor.

Në periudhën janar - qershor të vitit 2025, Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (APFBZHR) ka realizuar mjete në vlerë prej 5.511 milionë denarë (67.3% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara për vitin 2025). Zëri kryesor i këtij shfrytëzuesi buxhetor janë subvencionet dhe transfertat me pjesëmarrje prej 94.4% dhe për këtë zë u realizuan 5.204 milionë denarë, përkatësisht 73.6% nga planifikimi.

Në gjysmën e parë të vitit 2025, Ministria e Mbrojtjes ka realizuar mjete buxhetore në vlerë prej 10.362 milionë denarëve, që ishte 50.7% e buxhetit të përgjithshëm për këtë vit. Ato ishin për 9.9% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Në periudhën janar - qershor të vitit 2025, shpenzimet kapitale kishin pjesëmarrjen më të madhe sa i përket shpenzimeve me 43.1%, ku realizimi arriti në 4.461 milionë denarë (52.4% të mjeteve të përgjithshme të planifikuara). Shpenzimet për paga dhe kompensime kishin pjesëmarrje me 30.1% në

⁶ Në suaza të kësaj ndarjeje përfshihen aktivitetet në vijim: servisi në kohë i detyrimeve të shtetit bazuar në huamarrjen e brendshme dhe të jashtme; pagesa e rregullt e kostove operative të shtetit bazuar në dokumentacionin e pagesës së dorëzuar më parë; pjesëmarrja në kapitalin e institucioneve financiare ndërkombëtare; pagesa e TVSH-së bazuar në investimet kapitale të financuara nga donacionet, financimi i projekteve nga komponentët i caktuar të IPA-s, etj.

shpenzimet e përgjithshme. Për këtë qëllim u shpenzuan 3.121 milionë denarë, përkatësisht 46.9% nga vjera e përgjithshme e parashikuar.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2025, Ministria e Ekonomisë dhe Punës ka realizuar mjete në vlerë prej 2.467 milionë denarëve, që ishte 56.9% nga planifikimi për vitin në fjalë. Zëri më i rëndësishëm ishin transfertat rrjedhëse ndaj fondeve me pjesëmarrje prej 87.9%, ku u realizuan 2.168 milionë denarë ose 60.7% e mjeteve të planifikuara për vitin 2025.

Në gjysmën e parë të vitit, Ministria e Shëndetësisë ka realizuar mjete buxhetore në vlerë prej 3.013 milionë denarë (rënie prej 1.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak), që ishte 38.5% e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2025. Pjesëmarrjen më të madhe të shpenzimeve e zënë mallrat dhe shërbimet me 49%, ku u shpenzuan 1.478 milionë denarë në periudhën janar - qershor të vitit 2025, ose 42% e mjeteve të destinuara për vitin 2025. Zëri i dytë më i rëndësishëm ishte ai i transfertave rrjedhëse në fonde me pjesëmarrje prej 44.9% dhe në periudhën e analizuar u shpenzuan 1.354 milionë denarë për këtë qëllim, përkatësisht 38.7% e mjeteve të përgjithshme të parashikuara.

Në periudhën janar - qershor të vitit 2025, Ministria e Transportit ka realizuar mjete në vlerë 4.859 milionë denarë, që paraqet vetëm 2.5% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2025. Ato kanë shënuar rritje për 132.2 krahasuar me vitin e kaluar. Zëri me pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor ishin shpenzimet kapitale, ku në gjysmën e parë të vitit 2025 realizimi arriti në 4.390 milionë denarë (90.3% të shpenzimeve të përgjithshme), që ishte 26.6% e buxhetit vjetor për këtë destinim. Për subvencione dhe transfertat, u shpenzuan 276 milionë denarë, që ishte 39.3% e asaj që ishte planifikuar për tërë vitin, ndërsa në shpenzimet e përgjithshme kishin pjesëmarrje me 5.7%.


Në periudhën e dorëzimit të raportit, në procedurë parlamentare ishte edhe Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025. Ndryshimet që janë bërë kishin për qëllim rishikimin jo të theksuar të projeksioneve initiale fiskale në harmonizim me zhvillimet makroekonomike në gjysmën e parë të vitit, rishikimin e shpenzimeve buxhetore ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë për servisin e detyrimeve më prioritare, si dhe optimizimin e burimeve të financimit përmes shfrytëzimit të burimeve financiare nga aktivitetet vetëfinancuese. Përveç kësaj, u ruajt edhe niveli identik i deficitit buxhetor të planifikuar me buxhetin inicial. Me rishikimin e projeksioneve fiskale u realizua edhe harmonizimi i shpenzimeve me realizimin dhe pritshmëritë aktuale, përkatësisht u siguruan më tej mjete shtesë për pagesën e pagave, pensione, aktiviteteve programore dhe projektuese me shfrytëzimin e njëkohshëm të mjeteve nga vitet e kaluara në llogaritë e veçanta. Të hyrat e përgjithshme u planifikuan në nivel prej 362.4 miliardë denarëve, ose për rreth 1% më të larta, përkatësisht rreth 3.5 miliardë denarë më shumë në raport me projeksionet initiale në planin e vitit 2025.

3.2. Menaxhimi i borxhit publik

Borxhi shtetëror në fund të tremujorit të parë të vitit 2025 arriti në 8.328.7 milionë euro, përkatësisht 50.1% e PBB-së së projektuar për vitin 2025, ndërsa borxhi publik⁷ arriti në 9.583.9 milionë euro, përkatësisht 57.7% e PBB-së (Grafiku 13). Përveç kësaj, krahasuar me fundin e vitit 2024, pjesëmarrja e borxhit shtetëror në PBB ishte më e ulët për 3.7 p.p., ndërsa e borxhit publik për 4.7 p.p.. Të dhënat për nivelin e borxhit implikojnë ristabilizimin e tij, që vjen pas periudhës së rritjes së borxhit si pasojë e krizës së shkaktuar nga pandemia e Covid-19.

⁷ Me ndryshimet në Ligjin e Borxhit Publik në muajin maj të vitit 2019 ("Gazeta Zyrtare" nr. 98/2019), borxhi jo i garantuar përfshihet në përkufizimin e borxhit publik.


Grafiku 13. Gjendja e borxhit shtetëror dhe publik (në % të PBB-së)



Burim: Ministria e Financave

Nga aspekti i strukturës së interesit të borxhit qeveritar, në fund të tremujorit të parë të vitit 2025, raporti i normës fikse dhe variabile të interesit ishte përkatësisht 77.5:22.5 (Grafiku 14). Sa i përket kompozimit valutor, borxhi në valutën vendase përfshin 34.5% të portofolit të borxhit të përgjithshëm shtetëror, ndërsa borxhi i denominuar në valutën e huaj përfshin 65.5%. Përveç kësaj, pjesëmarrja e borxhit në euro në borxhin e përgjithshëm shtetëror ishte 60.6% (duke përfshirë letrat shtetërore me vlerë me klauzolë devizore), e të drejtave speciale të tërheqjes 4.7%, e borxhit në jenin japonez 0.2%, ndërsa e borxhit të denominuar në dollarë amerikan 0.03%.

Grafiku 14. Struktura e normës së interesit (majtas) dhe struktura valutore (djathtas) e borxhit shtetëror në tremujorin e parë të vitit 2025



Në periudhën janar - qershor të vitit 2025, Ministria e Financave emetoi rregullisht letra shtetërore me vlerë në tregun vendas, në përputhje me kalendarin e emetimit të letrave shtetërore me vlerë LSHV.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, u realizuan rishikime të rregullta të rejtikut kreditor të vendit nga agjencitë e rejtikut kreditor “Fitch” dhe “Standard & Poors”.

- **Në muajin janar të vitit 2025**, Agjencia e Rejtikut Kreditor “Standard & Poor's” e konfirmoi rejtikut kreditor të vendit me “BB-”, respektivisht me perspektivë stabile. Agjencia thekson përcaktimin e Qeverisë për reforma gjithëpërfshirëse me qëllim të përshejtimit të rritjes ekonomike, përforcimit të kapaciteteve administrative, luftës kundër korrupsionit dhe përforcimit të sundimit të ligjit. Në këtë raport, agjencia në fjalë thekson se prioriteti kryesor i Qeverisë ishte stimulimi i rritjes ekonomike dhe arritja e normave të rritjes deri në 5% përmes realizimit të projekteve të mëdha infrastrukturore.

- **Në muajin mars të vitit 2025**, Agjencia e Rejtikut Kreditor “Fitch” e konfirmoi rejtikut kreditor të vendit me “BB+”, respektivisht me perspektivë stabile. Agjencia thekson se në vitin 2024, rritja reale e PBB-së arriti në 2.8%, pavarësisht pengesave të jashtme dhe se ajo ishte mbi projeksionet, si rezultat i konsumit dhe investimeve të fuqishme publike.